



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.494/1 Prot.

Tiranë, më 27. 04 . 2023

V E N D I M

Nr. 65 , Datë 27. 04 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën nr. 57 Regj, datë 12.4.2023, të z. F.C kundër Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DV ASHK) Pogradec, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “moshës”, “aftësisë së kufizuar” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas pretendimeve dhe shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, shqetësimi i ngritur nga z. F.C ka të bëjë me problematikën e përsëritur ndër vite pranë Komisionerit, lidhur me aplikimin pranë DV ASHK Pogradec, për t’u pajisur me certifikatë pronësie për pasurinë e fituar me Aktin e Marrjes në Pronësi të Tokës (AMPT) nr. 6381/R, datë 18.04.2005.

Z. F.C pretendon se, me veprimet dhe mosveprimet me dashje, të kryera për arsye të korrupsionit nga DV ASHK Pogradec, në të cilën ka aplikuar sipas ligjit që prej vitit 2012, duke depozituar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, nuk është pajisur me certifikatën e pronësisë. Ai shpjegon se, është sorollatur me pretendimin se duheshin bërë disa procese teknike dhe e gjithë kjo ka ndodhur për shkak të korrupsionit.

Z. F.C deklaron se, në vitin 2015 zyra e regjistrimit i ka kërkuar dokumentacionin origjinal të pronës dhe në vijim të kësaj kërkese ai ka depozituar aktin e pronësisë, si dhe një vendim gjyqate ku saktësohet që parcela përkatëse e tokës së pretenduar prej tij ishte në juridiksionin e

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Komunës Cerravë dhe pronari i vjetër para 1991 u deklarua me vendim gjykatë që kishte qenë babai i tij, dhe sipas ligjit 7501 ai ishte plotësuar me tokë. Pas plotësimit të dokumentacionit ankuesi shpjegon se, nuk u pajis me certifikatë pronësie, por u njoftua nga ZVP Pogradec se duhet të bënte disa procese tekniko ligjore, pra “duhet të jepje lek”. Ankuesi deklaroi se, ka bërë ankesa në zyrën qendrore të regjistrimit të pasurive, në Kryeministri dhe Ministrinë e Drejtësisë, por nuk ka marrë zgjidhje. Përkundrazi, ai shprehet se, për të mbuluar korrupsionin e tyre, u vu në lëvizje Prefektura Korçë, me pretendimin se me ligjin e 2008 ky institucion duhet të aprovonte saktësinë e aktit të pronësisë. Sipas ankuesit një veprim i tillë është i pabazuar në ligj.

Edhe pse kanë kaluar shumë vite, rasti është në vazhdimësi dhe sipas ankuesit shkak për të paraqitur ankesën pranë Komisionerit është shkresa e DV ASHK Pogradec e datës 15.12.2021. Sipas ankuesit, kjo përgjigje e DV ASHK Pogradec është plotësisht korruptive dhe e diskriminon atë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen

nga Diskriminimi synon respektimin me rigozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

Së pari, lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga ana e DV ASHK Pogradec, sa i takon mosdhënies së certifikatës së pronësisë dhe njohjes së tij si pronar i ligjshëm i pronës, Komisioneri vlerëson se:

Nga verifikimet e kryera rezulton se pretendimet e parashtruara nga ankuesi janë shqyrtuar nga Komisioneri, në kuadër të disa ankesave të mëparshme, për të cilat Komisioneri është shprehur me vendimet respektive, si dhe nuk është depozituar asnjë provë apo fakt i ri për të filluar trajtimin e një çështjeje, shqyrtimi i së cilës për më tepër ndodhet jashtë kompetencave që LMD i atribuon Komisionerit. Kështu:

1. Nëpërmjet Vendimit nr. 87, datë 05.07.2019, Komisioneri ka vendosur mospranimin e ankesës me nr. regj. 74/2019, pasi ankesa ishte depozituar jashtë afateve ligjore dhe për shkak se *“e drejta për regjistrimin e pronës bën pjesë në kompetencën e ZQRPP ose zgjidhet në rrugë gjyqësore”*.
2. Nëpërmjet Vendimeve nr. 79, datë 30.07.2020, nr. 54, datë 01.04.2021 dhe nr. 73, datë 07.05.2021, Komisioneri ka vendosur mospranimin e tri ankesave të paraqitura nga ankuesi, me arsyetimin se e njëjta çështje, me të njëjtin objekt, të njëjtat shkaqe të pretenduara dhe kundër të njëjtave subjekte ishte shqyrtuar në kuadër të një anese të mëparshme të sjellë prej tij dhe se për të ishte dhënë një vendim i mëparshëm dhe nuk kishte të dhëna të reja.

Shkresa e datës 15.12.2021 e DV ASHK Pogradec, nuk mund t'a rivendosë ankuesin në afat për të paraqitur ankesë pranë Komisionerit, pasi me anë të vendimit nr. 87, datë 5.7.2019, i cili ka marrë formë të prerë, pretendimi i ankuesit për diskriminim është depozituar jashtë afateve ligjore që e lejojnë Komisionerin të marrë në shqyrtim një pretendim për diskriminim dhe për më tepër pretendimet e ankuesit janë jashtë kompetencave që LMD i jep Komisionerit.

Për sa më sipër, Komisioneri, mbështetur në nenin 33, pika 4/c, të LMD, i cili përcakton se: *“Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një anese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”*, gjykon se pretendimet e ankuesit për diskriminim nga DV ASHK Pogradec nuk mund të pranohen për shqyrtim, pasi Komisioneri është shprehur me vendime të mëparshme për të njëjtat pretendime të ankuesit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a dhe nenin 33, pikat 1 dhe 4/c të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit F.C, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja ekonomike, moshës, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë.
Fusha: Të mira e shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim